

DEBAT KOMBËTAR MBI BE-në

ANKETË DEBATIVE MBI MUNDËSITË DHE
SFIDAT E ADERIMIT TË MAQEDONISË NË BE

Përmbajtja

Pyetje dhe përgjigje	4
Bashkimi Evropian	5
Çështë BE?	5
Çfarë bën BE?	6
Maqedonia dhe BE	6
Pyetja nr. 1: Reformat demokratike	7
Gjendja aktuale: Demokracia dhe BE-ja	7
SFIDAT DHE MUNDËSITË - DEMOKRACIA	9
1. Qasjet e ndryshme: lloji i reformave	9
2. Qasjet të ndryshme: prioritetet reformatore	11
ÇFARË EFEKTESH DO TË KETË QASJA E REFORMAVE NË PËRGJITHËSI MBI SHOQËRINË DHE MË KONKRETISHT MBI INTEGRIMIN NË BE?	12
-Efekti mbi shoqërinë dhe marrëdhëniet ndëretnike	13
-Efekti i BE	14
Pyetja 2: Reforma ekonomike	15
Situata aktuale:Ekonomia dhe BE	15
SFIDAT DHE MUNDËSITË - EKONOMIA	17
1. Qasjet e ndryshme: integrimi i plotë ekonomik	17
2. Qasjet e ndryshme: anëtarësia shoqëruese/asociacioni	19
3. Qasjet e ndryshme: status quo	20
Agjendë	21
Ç'ËSHTË ANKETA DEBATIVE	22

Pyetje dhe përgjigje

Përse na nevojitet një dialog i hapur dhe i gjerë me qytetarët në lidhje me integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian (BE)?

Sikurse dhe në shumë vende tjera, procesi i integritit evropian i Maqedonisë ishte në masën më të madhe i udhëhequr nga elitat. Mungesa e një debati autentik, inkluziv, krijoi informacione sipërfaqësore dhe jo të plota, si dhe mungesë të të dhënave të qasshme dhe objektive mbi BE-në. Më sa duket, qytetarët e rëndomtë, ata jetesa e të cilëve më së shumti do të ndikohet nga aderimin në BE, u lanë anësh.

Anëtarësia në BE hap mundësi dhe sfida të numërta, të cilat kërkojnë sjelljen e vendimeve të rënda nga qeveritë kombëtare të vendeve të ardhshme anëtare. Si vend kandidat për anëtarësi të plotdrejtë në BE, Maqedonia varet nga mendimi i qytetarëve të vet, që të mund të bëjë një zgjedhje të drejtë dhe legjitime.

Debati kombëtar mbi BE-në ka për qëllim fuqizimin e kulturës së debatit të informuar publik në Republikën e Maqedonisë. Me inkuadrimin e qytetarëve në një diskutim të hapur me ekspertët dhe intelektualët e politikave evropiane, u jepet mundësia e shprehjes së pikëpamjeve të tyre. Konkluzionet dhe gjetjet e debatit kombëtar do të ndahen me politikëbërësit dhe vendimsjellësit relevantë, si dhe me publikun e gjerë.

Cili është qëllimi i këtij dokumenti?

Ky dokument është një përmbledhje e dy temave të cilat do të diskutohen gjatë ngjarjes debative.¹ Ai:

1. ofron informacione mbi Bashkimin Evropian;
2. ofron informacione mbi të dy temat: **reformat demokratike dhe ekonomike në Maqedoni;**
3. ofron disa **qasje të mundshme në politikat** në lidhje me dy temat dhe prezanton sfidat dhe mundësitë **për sa i përket aderimit të Maqedonisë në BE**, për çdo qasje veçmas.

Ekzistojnë tema të shumta për të diskutuar, mirëpo, për shkak të kohës së kufizuar, dokumenti fokusohet në demokracinë dhe ekonominë si dy tema mbizotëruese lidhur me integrimin evropian të Maqedonisë. Edhe pse dokumenti nuk prezanton të gjitha qasjet në politikat dhe argumentet për dhe kundër politikave, prapseprap mund të ju shërbejë si bazë për nxitjen e këtyre diskutimeve. Jeni të mirëseardhur për të diskutuar në lidhje me argumentet “për” dhe kundër”, të prezantuara në këtë dokument, si dhe t’i përfshini argumentet Tuaja personale për diskutim të mëtejshëm. Edhe pse dokumenti po përpjeket për ta inkurajuar diskutimin mbi anëtarësinë/qasjen e Maqedonisë në BE, argumentet për alternativa tjera janë poashtu të mirëseardhura.

A janë informacionet e dhëna në këtë dokument të balancuara dhe të paanshme?

Në hartimin e këtij dokumenti ishte shumë me rëndësi që informacionet e prezantuara të jenë objektive, të balancuara dhe të paanshme. U konsultuam me ekspertë të dalluar me pikëpamje të ndryshme për temat që po përpunohen në dokument, ndërsa hartuam këtë dokument me ndihmën e partnerëve tanë. Më poshtë vijojnë emrat e recensuesve që e kontrolluar dokumentin për sa i përket ekuilibrit dhe saktësisë:

- Malinka Ristevska Jordanova
- Besa Arifi
- Ivan Damjanovski
- Marjan Nikollov
- Verica Haxhi Vasileva Markovska
- Riste Jurukovski


¹ Anketa debative (deliberative polling) si metodologji është regjistruar nga ana e Qendrës për demokraci deliberative të Universitetit të Stanfordit: <http://cdd.stanford.edu>

Bashkimi Evropian

Çështë BE?

Zhvillimi fillestar i BE bazohet në Traktatin e Parisit (1951) dhe në Traktatin e Romës (1957) që themeluan Bashkësinë Ekonomike Evropiane (EEC). Gjashtë vende: Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda formuan një bllok të veçantë ekonomik dhe politik. Pas Traktatit të Mاستrihtit (1992), Bashkësisë iu dha emri Bashkimi Evropian dhe sot ai përbëhet nga 28 vende. Bashkimi është një aleancë e gjerë ekonomike dhe politike që mbulon politikën në mbi 30 fusha, duke përfshirë këtu të drejtat e njeriut, tregtinë, ekologjinë, energjinë, marrëdhëniet e jashtme dhe sigurinë, migracionin, drejtësinë dhe kështu me radhë.

Bashkimi Evropian bazohet në sundimin e ligjit, që do të thotë se baza e operimit të saj të përgjithshëm është marrëveshje vullnetare dhe demokratike në mes të anëtarëve të saj. Vendet anëtare në BE janë të përfaqësuar në dy organe: Këshilli Evropian dhe Këshilli i Evropës, ndërsa qytetarët janë të përfaqësuar drejtpërsëdrejti në Parlamentin Evropian (PE).



Çfarë bën BE?

BE ka vetëm kompetencat që i janë besuar nga Traktatet, dmth. vendet anëtare. Këto kompetenca ndahen në tri kategori kryesore:

- Juridiksione ekskluzive sipas të cilave vetëm BE mund të miratojë ligje dhe akte detyruese. Kjo përfshin fusha të tilla si dogana, konkurrenca, politika monetare, Euro.
- Kompetencat e përbashkëta ku vendet anëtare të BE dhe BE mund të shpallin ligje. Fushat kryesore të politikave përfshijnë tregun e brendshëm, bujqësinë, mbrojtjen e konsumatorit, transportin, drejtësinë dhe sigurinë.
- Kompetencat e mbështetjes aty ku BE-ja mund të ndërhyjë vetëm për të mbështetur, koordinuar ose plotësuar aktivitetet e shteteve anëtare. Fushat e politikave nën këto kompetenca përfshijnë, ndër të tjera, industrinë, kulturën dhe arsimin.

Maqedonia dhe BE

Pranimi në BE është një prioritet strategjik për Republikën e Maqedonisë. Në vitin 1992, të gjitha partitë në Kuvend unanimitisht miratuan deklaratën mbi vendosmërinë strategjike të vendit për t'u bashkuar me BE dhe NATO. Që atëherë, mbështetja publike për integrimin euro-atlantik ka mbetur e lartë. Me gjithë rënien e dukshme të viteve të fundit, asnjë nga subjektet kryesore politike në vend, që do të thotë, partitë, OJQ-të dhe publiku i gjerë, nuk kundërshtojnë publikisht dhe haptazi integrimin në BE dhe NATO.

Pikat kyçe të rrugës maqedonase për në BE janë:

- Më 9 prill 2001, Republika e Maqedonisë nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (SAA) me BE.
- Tashmë më 22 mars 2004 vendi parashtrroi kërkesën për anëtarësim në BE. Po atë vit, Qeveria e Maqedonisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.
- Më 15 dhjetor 2005, Këshilli Evropian zyrtarisht i dha Maqedonisë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE.
- Në tetor 2009, Komisioni Evropian (KE) rekomandoi që Maqedonia të fillojë negociatat e aderimit me Bashkimin Evropian. Përveç kësaj, qytetarëve u ofrohet liberalizimi i vizave për të udhëtuar në vendet e zonës së Shengenit.
- Në raportin e saj të vitit 2015, KE dha një rekomandim "të ngrirë" që u kushtëzua nga zgjidhja e krizës politike në vend.

Për t'u bërë një vend anëtar i BE-së, është e nevojshme të miratohet legjislacioni evropian (**Acquis**), i cili është një tërësi aktesh juridike dhe vendimesh gjyqësore që përbëjnë korpusin e së drejtës së BE-së. Kjo do të thotë se Maqedonia jo vetëm që do të duhet ta përafrojë dhe harmonizojë legjislacionin e saj me atë evropian, por ajo duhet ta pranojë dhe supremacinë juridike të tij. Për anëtarësim, është gjithashtu e nevojshme të respektohen të ashtuquajturat Kriteret e Kopenhagës të vitit 1993. Ato përbëhen nga një korpus konkret i reformave demokratike dhe ekonomike që anëtarët potencialë drejtojnë në rrugën e anëtarësimit në BE.

2 https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/international-affairs/enlargement_en

Pyetja nr. 1: Reformat demokratike

Gjendja aktuale: Demokracia dhe BE-ja

Reformat demokratike janë shtylla e zgjerimit të BE. BE vetë është krenare për të qenë një grup vendesh në të cilat normat demokratike të garantuara me ligj janë një kriter për pranim. Kjo do të thotë që para se të bashkohet, Maqedonia duhet t'i nënshtrohet një procesi të plotë demokratizimi.

Kriteret politike për aderim, të vendosura në Samitin e BE në Kopenhagen në vitin 1993, janë:

- stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimi dhe mbrojtja e pakicave.³

Maqedonia është një vend kandidat për anëtarësim në BE që nga viti 2005. Institucionet e saja politike garantojnë standardet minimale të BE-së në aspektin e demokracisë dhe sundimit të ligjit. Që pas pavarësimit në vitin 1991, janë bërë arritjet e mëposhtme:

- Vendi ka lëvizur nga demokracia e mëparshme njëpartiake, socialiste me një ekonomi të planifikuar drejt një demokracie liberale pluraliste, të bazuar në sundimin e ligjit dhe në parimet e tregut të lirë.
- Liria e fjalës, shprehjes dhe mediat janë institucionalizuar, ndërsa qytetarët e Maqedonisë mund lirshëm të përzgjedhin midis mendimeve të ndryshme politike.
- Partitë e organizuara politike u shndërruan në subjektet kryesore politike, ndërsa zgjedhjet janë testi bazë i ideve të tyre të kundërshtuara. Stabiliteti politik (me disa përjashtime, siç ishte konflikti i armatosur i vitit 2001) u mirëmbajt; - përkundër dështimeve të kohëpaskohshme, partitë maqedonase dhe ato etnike shqiptare po bashkëpunojnë në nivelin institucional gjatë kësaj periudhe.

Gjithashtu, ne u përballuam edhe me sfida:

- Ndarja e pushtetit kurrë nuk u zbatua në tërësi për të siguruar pavarësinë dhe një sistem të “bashkimit dhe frenimit” në mesin e degëve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të pushtetit.
- Elitat politike kapën proceset demokratike dhe procesi i tranzicionit u shënuar nga korrupsioni dhe klientelizmi partiak.
- Marrëdhëniet ndëretnike mbetën të brishta gjatë viteve dhe qytetarët përgjithësisht ishin të përjashtuar nga proceset e vendimmarrjes.
- Sovraniteti i popullit, pavarësisht nga garancitë kushtetuese, mbeti më tepër formal sesa një kategori esenciale.

Në tërësi, lufta e pabalancuar për demokracinë shënon vitet e tranzicionit. Me fjalë të tjera, demokracia formale dhe procedurale mbisundoi demokracinë thelbësore, gjegjësisht, atë egalitare. Bazuar në këtë, vëzhguesit si “Freedom House” e klasifikuan sistemin politik në Maqedoni si një “qeveri kalimtare apo regjim hibrid”. Me fjalë të thjeshta, është një sistem administrimi në të cilin, megjithëse po mbahen zgjedhjet, qytetarët janë të prerë nga informacionet rreth aktiviteteve të atyre që ushtrojnë fuqinë e vërtetë, për shkak të mungesës së lirive qytetare. Në parim, kjo mund të ilustruhet nga renditja demokratike e vendit. Në nivelin 1 (më i miri) deri në 7 (më i keqi), vlerësimi i vendit është përqësuar nga 3.82 në vitin 2007 në 4.29 në vitin 2016.⁴ Shikoni Tabelën më poshtë.

3 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/accession-criteria_en

4 <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2016/macedonia>

Kategoria i kombeve në tranzicion; vlerësimi i demokracisë: Maqedonia⁵

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sundimi demokratik kombëtar	3.75	4.00	4.00	4.00	4.00	4.25	4.25	4.25	4.25	4.75
Procesi zgjedhor	3.25	3.25	3.50	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.50	3.75
Shoqëria civile	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.50	3.25
Mediat e pavarura	4.25	4.25	4.25	4.25	4.50	4.75	4.75	5.00	5.00	5.25
Sundimi demokratik lokal	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	4.00
Korniza dhe pavarësia gjyqësore	3.75	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00	4.25	4.25	4.25	4.50
Korrupsioni	4.75	4.50	4.25	4.00	4.00	4.00	4.00	4.25	4.25	4.50
Vlerësimi i demokracisë	3.82	3.86	3.86	3.79	3.82	3.89	3.93	4.00	4.07	4.29

Megjithatë, përkundër statusit të kandidatit të BE-së që nga viti 2005, me të cilin janë njohur përpjekje (të caktuara, nëse jo dhe të plota) për demokratizim, vendi nuk mund të hapte negociatat me Komisionin Evropian për anëtarësim në BE. Kjo është për shkak të dy arsyeve kryesore:

- “Kontesti mbi emrin” afatgjatë me Greqinë
- Përkeqësimi i demokracisë në vend.

Shkurtimisht, për të filluar bisedimet e aderimit me BE-në, nevojitet pëlqimi i të gjitha vendeve anëtare. Greqia, siç është e njohur mirë, e ka kushtëzuar Maqedoninë me zgjidhjen paraprake të “kontestit mbi emrin”, që të mund të fillojnë negociatat e aderimit.

Veç kësaj, standardet demokratike të vendit, të cilat përbëjnë bazën e anëtarësisë në BE, janë përkeqësuar. Shumë faktorë relevantë, si dhe raportet e KE-së për përparimin e vendit drejt BE-së, treguan tendenca joliberalë dhe ekzistencën e një “shteti të pushtuar” në Maqedoni. Interesat private, kryesisht partiake ndikuan ndjeshëm, pra privatizuan punën e institucioneve shtetërore si qeveria, administrata publike, autoritetet gjyqësore, agjencitë rregullatore dhe mediat.⁶ Si rezultat i kësaj, u shtua polarizimi politik në vend. Në disa vitet e fundit, trazirat civile dhe protestat e vazhdueshme kanë mbushur hendekun demokratik. Marrëdhëniet ndëretnike ishin gjithashtu të vëna në pyetje, ndërsa u rritën dhe përçarjet politike të thella brenda-etnike. Antagonizmi partiak arriti nivele të papapara gjër më tani dhe paraqiste lajmërim për ngjarjet e 27 prillit 2017, kur një turmë e mllefosur sulmoi parlamentin, duke plagosur një numër të madh të deputetëve të opozitës.

Zgjedhja e qeverisë së re më 1 qershor 2017 hapi një mundësi të re. Qeveria ka njoftuar qartë qëllimin për kthimin e vendit në rrugën drejt BE-së. Tani, edhe pse është e qartë se vendi ka nevojë për reforma demokratike, sfida është që të përcaktojë dhe të zbatojë qasjen më të përshtatshme. Natyrisht, zgjedhja dhe ritmi i reformave do të jetë një reflektim i llojit të shtetit dhe shoqërisë në të cilën dëshirojmë të jetojmë. Ajo gjithashtu do të ndikojë në mundësitë tona të ardhshme për BE. Në këtë kontekst, dy pyetjet tona të përgjithshme janë:

1. Si duhet të vazhdojnë reformat demokratike?
2. Çfarë efektesh do të ketë qasja reformatore në përgjithësi mbi shoqërinë, dhe më konkretisht, mbi integrimin e vendit në BE?

⁵ Ibid.

⁶ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_public_of_macedonia.pdf

SFIDAT DHE MUNDËSITË - DEMOKRACIA

Sipas fjalëve të famshme të Abraham Lincoln, demokracia është sundimi i “popullit, nga populli dhe për popullin”. Me fjalë të tjera, demokracia është një tërësi formale e rregullave, procedurave dhe institucioneve, por edhe një mënyrë jetese. Është një gjendje e shoqërisë e cila karakterizohet nga një tendencë drejt barazisë. Në 25 vitet e kaluara, qytetarët e Maqedonisë kanë zbuluar se rregullat formale jo domosdo çojnë drejt një demokracie participative dhe egalitare. Si pasojë, ne kemi nevojë për ndryshim. Me qëllim që të sigurojmë jetë të denjë për qytetarët tanë dhe t'i bashkohemi BE-së, ne do të duhet t'i përforcojmë përpjekjet tona për demokratizim. Në kuptimin formal, procedural, ato përbëhen nga:

përforcimi i sundimit të ligjit dhe i praktikave të qeverisjes së mirë;

- reformat gjyqësore dhe depolitizimi i administratës publike; dhe
- liria e përmirësuar e mediave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Në esencë, ne duhet të fuqizojmë pjesëmarrjen qytetare në politikë, por edhe ta bëjmë shoqërinë më të barabartë. Ekzistojnë shumë mënyra të mundshme për ta arritur këtë.

1. Disa njerëz pretendojnë se vetëm reformat sistematike nga rrënja mund ta rivendosin sovranitetin e popullit. Megjithatë, ekzistojnë mospajtime rreth tempos së reformave. Disa njerëz angazhohen për ndryshime të përsheptuara të kryesuara nga qeveria, kurse njerëz të tjerë angazhohen për ndryshime graduale të cilat do të kryesoheshin nga shoqëria civile.

2. Disa njerëz besojnë se dhënia e përparësive të reformës në pjesë të caktuara të aparatit drejtues do të ishte më efektive - për shembull, gjyqësori dhe administrata publike; ndërsa të tjerët po bëjnë thirrje për reforma urgjente të mediave, të cilat do të sigurojnë një publik të shëndetshëm demokratik si parakusht i demokratizimit të përgjithshëm të vendit.

Në këtë kontekst:

- A duhet të vazhdojmë me reforma të shpejta dhe sistematike të udhëhequra nga qeveria kombëtare? Apo reformat graduale të demokratizimit të bëra nga shoqëria civile do të ishin më efikase në afatin e gjatë?
- A duhet t'i japim prioritetin më të lartë sigurimit të sundimit të ligjit dhe praktikave të qeverisjes së mirë? Apo janë reformat konzistente dhe të orientuara gjyqësore/administrative dhe/ose reformat në mediat, në fakt, rruga përpara?

1. Qasjet e ndryshme: lloji i reformave

Po shqyrtojmë dy lloje të ndryshme të reformave:

1. Reformat sistematike të drejtuara nga qeveria kombëtare – ndryshime të drejtuara vertikalisht, strukturore nga lartë poshtë, që nevojiten për ta transformuar sistemin në përgjithësi. Ato do të merrreshin me të metat strukturore të vendit, kryesisht me “shtetin e pushtuar” për të rivendosur sundimin demokratik. Për këto reforma të udhëhequra nga qeveria nevojiten udhëzime të qarta politike dhe shpesh kryhen nga organet administrative. Aktorët e numëruar përfshijnë: qeverinë, parlamentin, partitë politike.

2.Reformat graduale të udhëhequra nga shoqëria civile - ndryshime horizontale, të ngadalta dhe të balancuara në lidhje me ekspertizën e shoqërisë civile. Ato përqipen për reforma të vazhdueshme, por të plota që demokratizojnë sistemin nga poshtë në krye. Ato janë të nevojshme për ta, dhe bazohen në konsensus politik. Aktorët e numëruar: shoqëria civile (organizatat joqeveritare, lëvizjet joformale, qytetarët individualë) dhe qeveria.

	Mundësitë	Sfidat
<p>Qasja nr. 1:</p> <p>Reformat sistematike nga qeveria kombëtare</p>	<p>Kjo është mënyra e vetme për t'u marrë me korrupsionin politik të sistemuar dhe të degëzuar, i cili në 25 vitet e fundit po ngulfat demokracinë maqedonase.</p> <p>2. Siguron udhëheqje të qartë politike në proces nga urdhërat më të larta të qeverisë që garantojnë kontroll dhe efikasitet.</p> <p>3. Nënkupton shpejtësinë dhe fokusin e trajtimit specifik dhe të njëkohshëm të mangësive të sistemit.</p> <p>4. Një orientim drejt mangësive fundamentale të demokracisë maqedonase, siç është ndarja e pushtetit, duke siguruar pavarësinë e parlamentit, qeverisë dhe gjyqësorit.</p> <p>5. Do të sigurojë rregulla të rrepta të paracaktuara për përgjegjësinë e politikanëve, duke e bërë tërë procesin më transparent.</p> <p>6. Institucionet e reformuara shpejt dhe tërësisht do të sigurojnë sundimin e ligjit dhe praktikën e qeverisjes së mirë, e cila do të rezultojë në stabilitetin dhe efikasitetin e sistemit si tërësi.</p>	<p>1. Shpejtësia është viktimë në kurriz të përpikërisë – është pamundur që njëkohësisht të punohet në çdo defekt – shumë çështje të rëndësishme mund të lihen anësh.</p> <p>2. Reformat e udhëhequra nga qeveria do të vënë shumë pushtet në duart e aparatit qeverisës, duke ushqyer kështu tendencat autokratike.</p> <p>3. Reformat e shpejta do të ushtrojnë presion mbi sistemin në tërësi, duke zbuluar mangësitë e tij strukturore në fushën e kapitalit politik, shoqëror dhe njerëzor.</p> <p>4. Ndarja e rreptë e pushtetit kërkon një aparat më të fuqishëm për të mbikëqyrë procesin dhe vendos pushtet në tepërt në duart e agjencive të zbatimit të ligjit, për shembull: policia.</p> <p>5. Rregullat e rrepta mund të çojnë drejt rregullimit të tepërt dhe gjobave që kufizojnë autonominë dhe marrjen e iniciativave.</p> <p>6. Sigurimi i sundimit të ligjit është një proces afatgjatë dhe i vazhdueshëm - reformat e shpejta do të rrezikojnë ekuilibrin tanimë të dobët institucional.</p>
<p>Qasja nr. 2:</p> <p>Reformat graduale të udhëhequra nga shoqëria civile</p>	<p>1.Mundëson ndryshime të matura dhe ekspertizë të shoqërisë civile që përfundimisht do të çonin në ndryshime thelbësore në sistemin politik dhe ekonomik të një shoqërie.</p> <p>2.Mundëson pjesëmarrjen përfshirëse të të gjithëve në proceset demokratike dhe shmang problemet e qeverisjes së centralizuar duke siguruar njëkohësisht një sistem demokratik të qëndrueshëm.</p> <p>3.Sakrifikon shpejtësinë në kurriz të përpikërisë. Përqipet për një korpus të menduar të rregullave dhe procedurave të qeverisjes së mirë në lidhje me kontekstin e dhënë.</p> <p>4.Për reformat graduale nevojitet kohë, por ato çojnë drejt një ndryshimi më të thellë dhe më të përpiktë në shoqëri.</p>	<p>1.Përpikëria bie në barrën e shpejtësisë – efekti i reformave graduale do të mund të ndjehet vetëm në afat të gjatë.</p> <p>2.Ekziston rreziku i shtuar nga popullizmi dhe mund të çojë drejt “tiranisë e shumicës”.</p> <p>3.Për të arritur përpikërinë, nevojitet një qasje e organizuar, e cila mund të çojë drejt një rregullimi të tepruar dhe burokratizimit.</p> <p>4.Për shkak të kohëzgjatjes së tyre, reformat graduale mund të rrisin korrupsionin dhe të varen nga vullneti i vazhdueshëm politik për reforma.</p>

2. Qasje të ndryshme: prioritetet reformatore

Reforma me prioritet do të merreshin me mangësitë sistemore apo pjesët thelbësore të sistemit të radhitura sipas rëndësisë së tyre relative. Sipas sugjerimeve të veç përmendura, i kemi propozimet në vijim:

- Sundimi i ligjit dhe praktikat e sundimit të mirë: Krijimi i realizimit të pavullnetshëm të pushtetit politik në lidhje me dhënien e përparësisë dhe respektimit të rreptë të sundimit të ligjit. Sigurimi i përgjegjësisë dhe transparencës së funksionarëve të zgjedhur dhe institucioneve publike.
- Reforma në gjyqësor (duke e përfshirë edhe reformën e administratës publike): sigurimi i paanshmërisë së drejtësisë, si dhe pavarësinë e gjyqësorit dhe administratës publike.

Reforma në media: sigurimi i gazetarisë së pavarur dhe objektive.

	Mundësitë	Sfidat
Qasja nr. 1: Sundimi i ligjit dhe sundimi i mirë	<p>1. Sigurimi i sundimit të ligjit është hapi i parë dhe më i rëndësishëm në kthimin e demokracisë në Maqedoni.</p> <p>2. Sundimi i ligjit do të ketë për qëllim ndarjen e rreptë të pushtetit dhe do të sigurojë autonomi dhe mbizotërim të parlamentit (pushteti ligjvënës) mbi qeverinë (pushteti ekzekutiv)</p> <p>3. Praktikrat e udhëheqësisë së mirë do të sigurojnë pjesëmarrje të rritur, transparencë dhe llogaridhënie, duke nxitur demokratizim të thuktë.</p>	<p>1. Sigurimi i sundimit të ligjit është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm, çdo reformë e përshpejtuar mund të përfundojë me një efekt tërësisht të kundërt.</p> <p>2. Reformat në sundimin e ligjit janë një ngarkesë e madhe mbi sistemin si tërësi, duke i zbuluar mangësitë e tyre strukturore në kapitalin politik, shoqëror dhe njerëzor.</p> <p>3. Vendosja e një agjende për të arritur një udhëheqësi të mirë është një detyrë e ndërlikuar e cila nënkupton kredibilitetin e qeverisë, respektin e institucioneve dhe pushtetin e llogaridhënies para qytetarëve.</p>
Qasja nr. 2: Reforma gjyqësore	<p>1. Sigurimi i përparësisë së drejtësisë dhe pavarësisë së gjyqësorit është jetik dhe i rëndësishëm për idenë e ndarjes së pushtetit.</p> <p>2. Gjyqësori i reformuar dhe i pavarur do të zvogëlojë praktikën e drejtësisë selektive dhe korrupsionit politik.</p> <p>3. Qasja e barabartë tek një drejtësi efektive dhe e paanshme është e një rëndësie të veçantë për pajtimin e shoqërisë. Kjo çon deri tek rendi dhe siguria dhe e përforcon konsensusin demokratik politik.</p>	<p>1. Reformat gjyqësore mund të jenë efektive vetëm si pjesë e reformave më të gjera të sistemit politik në vend apo reformave ligjore.</p> <p>2. Pavarësia e gjyqësorit mund të arrihet vetëm nëse qëndron larg degëve të tjera të pushtetit. Për këtë është i nevojshëm vullneti politik i fuqishëm dhe eksplicit.</p> <p>3. Paanshmëria e drejtësisë është një detyrë mjaft e rëndë për shoqëritë tradicionale, paternaliste dhe klienteliste siç është Maqedonia.</p>
Qasja nr. 3: Reforma në media	<p>1. Sigurimi i lirisë së mediave është gazetaria e pavarur dhe objektive.</p> <p>2. Prerja e marrëdhënies së korruptuar ndërmjet pronarëve të mediave, politikanëve dhe gazetarëve</p> <p>2. Krijimi i një sfere të shëndoshë publike si parakusht për një demokraci autentike.</p>	<p>1. Reformat në media do të ballafaqohen me sfidat e një tregu të lirë të mediave (dhe të rregulluar keq)</p> <p>2. Lidhjet klienteliste midis mogulëve të mediave dhe politikanëve do të kthejnë goditjen.</p> <p>3. Mungesa e kulturës dhe etikës në media do të del si pengesë kulturore shtesë.</p>

ÇFARË EFEKTESH DO TË KETË QASJA E REFORMAVE NË PËRGJITHËSI MBI SHOQËRINË DHE MË KONKRETISHT MBI INTEGRIMIN NË BE?

Reformat demokratike e kushtëzojnë dukjen afatshkurte dhe afatgjate të shoqërisë maqedonase. Reformat më të thella demokratike e përforcojnë legjitimitetin e sistemit dhe do të zmadhojnë kohezionin politik dhe social. Do të jenë të prekura edhe marrëdhëniet ndëretnike si njëra nga shtyllat e saja kryesore. Stabiliteti i rritur, toleranca dhe mirëkuptimi i dyanshëm janë gjithashtu të lidhura me tempon e reformave.

Lloji i reformave demokratike me siguri do të barazojë, apo do të shpërndajë dinamikën e aderimit drejt BE-së. Reformat tërësore, gjithsesi, do të jenë nxitje e fuqishme në drejtim të agjendës së BE-së. Demokratizimi autentik do të forcojë sundimin e ligjit, institucionet dhe qeverisjen e mirë, dhe do të përmirësojë në masë të madhe rradhitjen e lirisë së medias dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Duke marrë parasysh përfshirjen e tyre në kriteret për zgjerim në Kopenhagë, ata me siguri do të sjellin deri tek integrimi i plotë në BE dhe tek anëtarësimi. Reformat graduale do ta ruajnë trajektorinë tonë për aderim në BE të hapur, por të kushtëzuar me reformim të vazhduar.

Efeki mbi shoqërinë dhe marrëdhëniet ndëretnike

	Mundësi	Sfida
<p>Qasja nr.1:</p> <p>Reformat sistematike të udhëhequra nga</p>	<p>1.Udhëheqja politike e procesit mund të drejtojë dhe zbut reformat e demokratizimit që do të sigurojnë efikasitet dhe efektivitet.</p> <p>2.Kjo dhe fokusi i sundimit të ligjit dhe praktikave të qeverisjes së mirë mund të rezultojnë në stabilitetin dhe efikasitetin e sistemit në tërësi.</p> <p>3.Në praktikë, kjo reflekton si zbutje e antagonizmave shoqërore dhe politike duke krijuar hapësirë për një konsensus më të gjerë politik.</p> <p>4.Roli i rritur i elitave etno-politike në këtë proces mund të ballafaqohet në mënyrë efektive me marrëdhëniet ndëretnike në vend.</p> <p>5.Gjithashtu mund të ris praktikave të vendimmarrjes konsensuale dhe të ris dialogun politik midis elitave.</p> <p>6.Ky dialog mund të çarmatosë etnocentrizmin si burim i ndarjes dhe përçarjes në vend.</p>	<p>1.Efektiviteti bie në barrën e mangësive strukturore të sistemit dhe mangësive të kapitalit politik, shoqëror dhe njerëzor.</p> <p>2.Vendosja e sundimit të ligjit është një proces afatgjatë dhe i vazhdueshëm.</p> <p>3.Rritja e rolit të elitave etnopolitike në proces mund të sjell deri tek pazarllëku politik.</p> <p>4.Mund të vijë deri tek dobësimi i identiteteve kolektive që do të shkaktonin një reagim të ashpër nga grupet nacionaliste, sepse nxit ideologjinë e tyre kolektiviste si burimi i vetëm, ose së paku kryesor, i legjitimitetit politik.</p> <p>5. Demokracia konsensuale mund të sjellë deri tek shteti binacional.</p>
<p>Qasja nr.2:</p> <p>Reforma graduale të udhëhequra nga shoqëria civile</p>	<p>1.Reformat graduale të udhëhequra nga shoqëria civile janë inkluzive dhe do të demokratizojnë shoqërinë nga poshtë lartë.</p> <p>2.Ata e përforcojnë dialogun horizontal dhe të vazhdueshëm midis të gjithëve, që sjell deri tek stabiliteti i sistemit.</p> <p>Dialogu i vazhdueshëm mund të zvogëlojë antagonizmat social dhe politik duke krijuar hapësirë për konsensus më të gjerë politik.</p> <p>4.Konsensusi i përforcuar demokratik do të transformojë përçarjet etnike në vend.</p> <p>5.Gjithashtu, do të mund të risë identitetet qytetare në llogari të etnocentrizmit.</p>	<p>1.Demokratizimi gradual bien në barrën e urgjencës së reformave demokratike në vend.</p> <p>2.Dialogu horizontal është i kundërt me efektshmërinë dhe vendosshmërinë e cila është e nevojshme në proceset e reformave.</p> <p>3.Antagonizmat shoqërore dhe politike mund të zvogëlohen vetëm si rezultat i pazarit midis elitave politike.</p> <p>4.Reformat graduale mund të ndikojnë në mënyrë negative mbi marrëdhëniet ndëretnike. Nëse ekzistojnë vetëm përmirësime marginale, atëherë ndarjet etnike, praktikave të ndarjeve dhe segregacionit sipas gjitha gjasave do të vazhdojnë dhe do të përforcohen.</p>

Efekti i BE

	Mundësi	Sfida
<p>Qasja nr.1:</p> <p>Reformat sistematike të udhëhequra nga qeveria kombëtare</p>	<p>1.Reformat e shpejta dhe sistematike të udhëhequra nga qeveria do të kthejnë vendin në rrugën drejt BE-së.</p> <p>2.Reformat e synuara nga qeveria mund të përqendrohen në kërkesat specifike të BE dhe në mënyrë efektive të përmirësojnë radhitjen demokratike dhe ekonomike të vendit.</p> <p>3.Ky lloj reformash, gjithashtu, do të ballafaqohet me problemin e emrit dhe do të përgatisin shoqërinë për kompromisin e nevojshëm me Greqinë.</p> <p>4. Anëtarësimi i shpejtë në BE do të sigurojë stabilitet politik dhe prosperitet afatgjatë politik të vendit dhe do të çarmatosë etnocentrizmin.</p>	<p>1.Tempoja e shpejtë e integritit në BE do të ketë efekte negative mbi vendin O ajo do të jetë e papërgatitur për tu ballafaquar me kërkesat demokratike dhe ekonomike për anëtarësim të plotë në BE.</p> <p>2. Reformat e centralizuara mund të rrisin natyrën elastike të procesit të integritit në BE dhe të tëhuajsojë qytetarët e rëndomë nga procesi.</p> <p>Anëtarësimi i shpejtë në BE mund të thotë lëshime të rënda dhe të papranueshme për sa i përket çështjes së emrit.</p> <p>4. BE do të ngel qëllim në vete dhe maksima e vërtetë demokratike.</p>
<p>Qasja nr.2:</p> <p>Reforma graduale të udhëhequra nga shoqëria civile</p>	<p>1.Reformat graduale do të përgatisin vendin në mënyrë të plotë për aderim në BE.</p> <p>2. Ata do të forcojnë dialogun horizontal dhe të vazhdueshëm mbi mundësitë dhe sfidat e vendit gjatë integritit në BE.</p> <p>3. Më shumë kohë do të sigurohet për një rishikim racional të reformave specifike demokratike dhe ekonomike të BE.</p> <p>4.Çështja e emrit do të shqyrtohet tërësisht dhe në mënyrë demokratike, duke përgatitur vendin për kompromis dhe anëtarësimin përfundimtar në BE</p> <p>5. Alternativat për anëtarësim në BE do të mendoheshin dhe braktiseshin si jorealiste dhe irracionale.</p>	<p>1.Reformat graduale do të vazhdojnë me kushtëzimin e procesit të pranimit në BE dhe mund të rrisin shanset e korrupsionit politik në vend.</p> <p>2.Dialogu horizontal do t'i japë gjithashtu zë kundërshtarëve të BE</p> <p>3.Konsensusi racional kërkon kohë dhe do të zgjasë reformat e nevojshme demokratike dhe ekonomike.</p> <p>4.Shqyrtimi i plotë i çështjes së kompromisit për emrin, për shkak të ndjeshmërisë kulturore dhe identitetit, mund të ndikojë gjithashtu në braktisjen e idesë për anëtarësimin e domosdoshëm të vendit në BE.</p> <p>5.Në bazë të asaj që u tha më sipër, idetë për alternativat e anëtarësimit në BE do të fitonin zëshmeri.</p>

Pyetja 2: Reforma ekonomike

Situata aktuale:Ekonomia dhe BE

Integrimi ekonomik është njëra nga forcat kryesore lëvizëse pas kandidaturës së Maqedonisë për aderim në BE. BE para së gjithash, është klub i vendeve të zhvilluara ku niveli i mirëqenies ekonomike i qytetarëve të saj është ndër më të lartat në botë. Për të arritur këtë nivel, ekonomia e Maqedonisë duhet të jetë e rekonstruuar tërësisht.

Kriteret ekonomike të nevojshme për t'u bashkuar me BE, të miratuara në qershor të vitit 1993 nga Këshilli Evropian në Kopenhagë janë:

- ekonomia funksionale e tregut dhe
- kapaciteti për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.⁸

Natyrisht, si një vend kandidat, Maqedonia i përmbush standardet minimale ekonomike për pranim në BE. Nga pavarësia në 1991 dhe këtej:

- Raportet e tregut dhe liritë ekonomike kanë zëvendësuar ekonominë e mëhershme të drejtuar nga shteti
- Privatizimi masiv i sektorit të mëhershëm shtetëror dhe publik i ka liberalizuar raportet ekonomike në vend.
- Reformat e dhimbshme, por të domosdoshme strukturore dhe programi i stabilizimit makroekonomik, krijuan një rishpërndarje të shtuar ekonomike.

Sfidat, nga ana tjetër, ishin të shumta:

- Filozofia e tregut të lirë dhe privatizimi masiv në vitet 1990 la një ushtri të qytetarëve të papunë.
- Embargoja e OKB-së ndaj Serbisë fqinje, embargoja greke, si dhe konflikti i vitit 2001, kanë vënë presion të madh mbi ekonominë ende të pazhvilluar. Kriza e fundit politike ka tensionuar edhe më tej perspektivat ekonomike.
- Pavarësisht stabilitetit makroekonomik, rritja e përgjithshme e PBB-së dhe PBB-së për frymë mbetet e ulët ose e pakënaqshme.

Në përgjithësi, zhvillimi ekonomik i vendit gjatë viteve të tranzicionit ishte i ndryshueshëm dhe i paqartë. Përkundër radhitjes së lartë të lirive ekonomike në vitet e fundit ("kryesisht i lirë" - 31 në nivel global), e cila, si ilustrim, e vendos vendin në një vend shumë më të mirë se shumë vende të BE-së⁹ ecuria e përgjithshme ekonomike e vendit është ende e brishtë. E tillë është edhe cilësia ekonomike e jetës së qytetarëve të saj.

Rritja vjetore e PBB vitet 1990 - 2016

	1990	2000	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Maqedonia	..	4.5	6.5	5.5	-0.4	3.4	2.3	-0.5	2.9	3.6	3.8	2.4

Përgatitur nga: Tregues botëror të zhvillimit (World Development Indicators)

Seri: rritja e PBB (vjetor %)¹⁰

8 https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/economic-and-fiscal-policy-coordination/international-economic-relations/enlargement-and-neighbouring-countries/enlargement/economic-accession-criteria_en#economiccriteriaforjoiningtheeu

9 <http://www.heritage.org/index/ranking>

10 <https://data.worldbank.org/country/macedonia-fyr>

Rritja e PBB për kokë banori vitet 1990 - 2016

	1990	2000	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Maqedonia	3,853.9	3,448.8	4,192.9	4,418.3	4,398.8	4,542.9	4,645.5	4,620.6	4,751.9	4,920.2	5,104.8	5,222.8

Përgatitur nga: Tregues botëror të zhvillimit (World Development Indicators)

Seria: PBB për kokë banori (konstanta 2010 USD) ¹¹

Sot, opinioni që mbizotëron në mesin e shumicës së qytetarëve maqedonas është se pranimi në Bashkimin Evropian do të përmirësojë cilësinë e jetës, në aspektin e arritjeve ekonomike, sociale dhe politike. Natyrisht, qytetarët e BE gëzojnë kushte shumë më të mira shoqërore dhe ekonomike në krahasim me Maqedoninë. Treguesit kryesor ekonomik janë në dobi të kësaj teze.

Fusha	Maqedoni	BE
Produkti i brendshëm bruto sipas paritetit për fuqinë blerëse	<ul style="list-style-type: none"> •36% nga PBB PPP të BE 28 në vitin 2015 •35% në 2013 	•28.900 euro sipas çmimeve të tregut
Konsumi aktual sipas paritetit të fuqisë blerëse	<ul style="list-style-type: none"> •41% nga mesatarja e BE 28 në vitin 2015 •39% në vitin 2013 	•26.700 euro me çmime të tregut
Niveli i papunësisë	•26,1% në vitin 2015	•9,4% në BE 28
Banorë me rrezik për të tejkaluar pragun e varfërisë	•21,5% nga banorët e Maqedonisë në vitin 2015	•17,2% nga banorët në BE 28
Pabarazi në shpërndarjen e të ardhurave	•20% më të lartë e popullsisë (me të ardhurat ekuivalente më të lartë të disponueshme) në Maqedoni në vitin 2015 ka marrë 6.6 herë më shumë të ardhura sesa 20% më të ulëta (me të ardhurat më të ulëta ekuivalente të disponueshme)	•Ky raport në BE 28 në të njëjtin vit ka qenë 5.2 herë.

Nëse Maqedonia bashkohet me BE, do të bashkohet me një nga blloqet më të forta ekonomike dhe tregtare në botë, i cili përbëhet nga 500 milionë njerëz që përfaqësojnë 7.3% të popullsisë botërore dhe deri në 23% të PBB-së nominale globale. Megjithatë, hyrja në hapësirën ekonomike të BE-së nuk është pa kurrfarë rreziku. Tregu i vetëm evropian mund të tregohet si sfidë e madhe për disa vende.

Përsëri edhe një sërë vendimesh të rënda qëndrojnë para nesh. Pyetja e radhës me rëndësi të veçantë:

1. Si do të duhet të vazhdojmë me integrimin ekonomik në BE?

SFIDAT DHE MUNDËSITË - EKONOMIA

Sipas fjalëve të Adam Smith, themeluesit të shkencës bashkëkohore për ekonominë, “asnjë shoqëri nuk mund të jetë prosperuese dhe e lumtur, nëse pjesa më e madhe e saj janë të varfër dhe në mjerim”. Si pasojë, në përgjithësi, qëllimi i ekonomisë është të sigurojë prodhim, shpërndarje dhe konsum të mallërave dhe shërbimeve të cilat do të plotësojnë nevojat e shoqërisë dhe banorëve të saj. Nga pavarësia në vitin 1991 Maqedonia ka luftuar të sigurojë dhe mirëmbajë kushte të qëndrueshme për jetesë për qytetarët e saj. Ndërsa siç ilustron në grafikonët më lartë, ne jemi ende larg mesatares së BE-së.

Reformat e deritanishme ekonomike në vend ishin të rregulluara për të plotësuar kriteret nga BE nga Kopenhaga, për liberalizim e tregut dhe konkurrenca në kuadër të Unionit. Statusi i kandidatit për BE, vërteton se janë të plotësuarat kërkesat themelore nga BE. Tani, kur vazhdojmë tutje, çështja në fokus të interesit tonë është çfarë roli do të ketë statusi ynë në BE për zhvillimin tonë të përgjithshëm ekonomik.

1. Sipas disave, vetëm një integrim më i shpejtë dhe i plotë ekonomik në Union do të kishte efekte të matshme dhe të thella mbi ekonominë e Maqedonisë. Shkurtimisht, vendi do të shfrytëzonte përfitimet nga fondet strukturore të BE-së dhe do të fillonte me zhvillim të përshpejtuar ekonomik të bërë sipas masave të BE-së.

2. Të tjerët konsiderojnë se integrimi i shpejtë ekonomik në BE mund të ketë dhe ndikime të kundërta socioekonomike. Sipas tyre, statusi i tanishëm i vendit kandidat (anëtare shoqëruese e BE-së) siguron mbështetje të mjaftueshme dhe finansim nga BE, njëkohësisht duke e përgatitur vendin për kushtet e ashpra të konkurrencës së tregut në tregun e vetëm të BE-së.

3. Në fund, duke marrë parasysh situatën e ndërlikuar për sa i përket çështjes me emrin, disa propozojnë të merren parasysh edhe alternativat ekonomike jashtë BE-së.

Në këtë kontekst:

- A duhet të synojmë drejt një integrimi të përshpejtuar drejt BE-së, e cila, supozojmë do të përmirësojë dukshëm perspektivat e përgjithshme ekonomike të vendit?
- A duhet të vazhdojmë me reforma themelore, por graduale ekonomike, të cilat, duke marrë parasysh statusin tonë të vendit shoqërues në BE, gradualisht do të adaptojnë ekonominë dhe shoqërinë tonë drejt një integrimi të plotë ekonomik në BE?
- A duhet të heqim dorë nga planet për anëtarësim në BE dhe të kërkujmë tregje dhe perspektiva të reja?

1. Qasjet e ndryshme: integrimi i plotë ekonomik

Integrimi i plotë ekonomik është faza e fundit e integritit evropian në BE. Ajo çon drejt instalimit të plotë në Tregun e Vetëm Evropian – një territor pa asçfarë kufish të brendshme ose pengesash tjera rregullatore për lëvizje të lirë të mallrave dhe shërbimeve. Për t’iu bashkëngjitur dhe për t’u barazuar me vendet tjera të BE-së, Maqedonia duhet ta mbyllë hendekun në krahasim me vendet tjera të BE në lidhje me treguesit kryesor ekonomik, social dhe të tjerë të zhvillimit. Veç kësaj, integrimi i plotë ekonomik nënkupton delegimin e një pjese të rëndësishme të sovranitetit ekonomik të vendit të institucioneve kolektive të BE-së. Si rezultat i kësaj, do të duhet të heqim dorë nga një pjesë të madhe të autonomisë së vendit në çështjet ekonomike, që do të bëhet lëndë e vendimeve të përbashkëta dhe detyruese.

Në përgjithësi, duke iu referuar përvojës së vendeve të Evropës Lindore që u bashkuan me BE në dekadën e fundit, efektet neto të anëtarësimit të plotë mund të jenë pozitive, por edhe negative. Për të parat, merren parasysh treguesit e mëposhtëm:

- rritja e prodhimit të brendshëm bruto, rritja e investimeve të huaja direkte dhe reduktimi i borxhit të jashtëm të sektorit publik.

Treguesit për të dytat, i.e. efektet negative janë kryesisht:

- inflacioni më i lartë, rritja e deficitit të llogarisë aktuale dhe borxhi i jashtëm i sektorit privat.

Nëse merret parasysh kjo, së bashku me afërsinë krahasuese të ekonomisë maqedonase me ish-fqinjët e saj socialistë, integrimi i plotë ekonomik do të ofronte mundësitë dhe sfidat e vendit.

	Mundësitë	Sfidat
Qasja nr. 1: Integrimi i plotë ekonomik	<p>1.Vendit do t'i ndahet një ndihmë e madhe financiare, teknike, shkencore, institucionale nga fondet strukturore, kohezive, agrare dhe fondet tjera, të cilat do të ndihmojnë në fuqizimin e modernizimit strukturor të ekonomisë.</p> <p>2.Ekonomia do të punojë nën presionin e tregut të konkurrencës të brendshëm të BE-së. Të paktën në teori, nënshtrimi në konkurrencë më të madhe do të duhej ta avanconte produktivitetin dhe ta rriste konkurrencësinë.</p> <p>3.Tregtia e lirë dhe mënjanimi i barrierave jotarifore do të duhej të ndihmonte për prritjen e tregtisë me BE për kompanitë maqedonase.</p> <p>4.Lëvizja e lirë e punës dhe nxënësve do t'u mundësojë qytetarëve maqedonas që të jetojnë, të mësojnë dhe të punojnë në BE, por dhe e kundërta. Gjithashtu, ata do t'i gëzojnë përfitimet e skemës së mbrojtjes sociale të BE-së.</p> <p>5.Përfitimet nga korniza e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB) do ta sigurojnë ekzistimin e një oferte të qëndrueshme dhe të disponueshme e ushqimit, e cila përmbush standardet e BE-së – anëtarësia në BE gjithashtu siguron një qasje të plotë në Tregun e Vetëm për tregtimin e produkteve bujqësore.</p> <p>6.Legjislacioni i BE-së ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit jetësor, për t'u bërë ballë ndryshimeve klimatike dhe për ta promovuar sigurinë energjetike dhe rrjetet dhe tregjet energjetike – si pasojë, qytetarët maqedonas do të përfitojnë nga rrjetet dhe tregjet energjetike.</p>	<p>1.Përshtatja strukturore mund ta përmirësojë gjendjen gjithpërfshirëse të ekonomisë, por prapëprap mbetet të shikohet se sa me sukses dhe me mençuri do ta shfrytëzojmë këtë.</p> <p>2.Konkurrencshmëria e e madhe në tregjet e BE do të thotë se disa nga kompanitë e brendshme me siguri se nuk do të mbijetojnë. Për shembull, Sllovenia, ekonomia e së cilës ishte dukshëm më e zhvilluar sesa ajo e Maqedonisë, e kishte patjetër ta privatizonte dhe shiste shumicën e kompanive të veta më të mëdha (Iskra, Elan, Gorenje, etj.).</p> <p>3. BE funksionon si një bashkim doganor me tarifë të jashtme të përbashkët për mallra që hyjnë në Tregun e Vetëm të BE-së, që siguron pozicionimin e fuqishëm negocues për vende anëtare, por njëkohësisht do të thotë dhe se vendet individuale anëtare tanimë nuk gëzojnë të drejtën që në mënyrë individuale të dakordojnë tarifa të ndryshme me vendet që nuk janë anëtare të BE-së.</p> <p>4. Rregullat e BE-së sigurojnë furnizime publike të amllrave, shërbimeve që janë të hapura për të gjitha kompanitë e BE-së në bazë të mosdiskriminimit – që është me rëndësi për t'i mënjanuar parregullësitë; të sigurojnë koncesione të ndershme, që është e mirë për konkurrencën, por mund të dëmtojë kompanitë e brendshme.</p> <p>5. Humbja e pavarësisë së politikës monetare, dhe deri diku dhe në politikën fiskale të kursit të monedhave, plotësisht mund t'i rrezikojë perspektivat e ekonomisë. Kështu, problemet e kohëpaskohshme në rritjen dhe në krizat në ekonominë e BE-së do të kishin mund lehtë të kalohen mbi ekonominë maqedonase. Në të njëjtën kohë, presionet për t'iu përmbajtur masave të kursimit mund të çojnë drejt stagnimit ekonomik. Rasti i Greqisë fqinje është një shembull i ndikativ në masë të madhe.</p> <p>6. Në fund, standardet dhe rregullat bujqësore të BE-së mund të çojnë drejt mbylljes së detyruar të disa prodhuesve.</p>

2. Qasjet e ndryshme: anëtarësia shoqëruese/asociacioni

Statusi i shoqatës zakonisht përcaktohet nga një marrëveshje asociimi, siç është Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) midis BE-së dhe Maqedonisë. Marrëveshja synon të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera në rajon, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm të zbrapsjeve të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve. Bashkëpunimi rajonal gjithashtu përfshin krijimin e një zone të lirë tregtare midis vendeve të lidhura me BE nga MSA. Ekzistojnë dispozita lidhur me katër liritë: lëvizja e mallrave, lëvizja e punëtorëve, sigurimi i shërbimeve; dhe lëvizja e kapitalit. Kjo Marrëveshje në mënyrë të njëanshme u jep kushte më të favorshme tregtare vendeve pjesëmarrëse në procesin e stabilizimit dhe asociimit gjatë një periudhe kohore. Statusi i një anëtari shoqërues ndihmon promovimin e marrëdhënieve ekonomike harmonike dhe gradualisht zhvillon një zonë të tregtisë së lirë midis BE-së dhe Republikës së Maqedonisë. Statusi i një anëtari shoqërues konsiderohet si një fazë në procesin e aderimit në BE. Në këtë mënyrë, ekonomia kombëtare gradualisht i nënshtrohet ekonomisë së BE-së, duke mundësuar kështu kalimin më të lehtë në një treg shumë më të madh, nëpërmjet të masave asimetrike të mbrojtjes.

Kjo fazë korrespondon me zhvillimin aktual të Maqedonisë në të cilin disa reforma janë zbatuar nga axhenda e gjerë për pranimin në BE. Kjo do të thotë se vendi mbetet më pak apo më shumë i pavarur nga BE, por miraton legjislacionin e caktuar, si dhe reformat në mjedisin e biznesit ose përmirësimin institucional me qëllim të avancimit të mjedisit afarist dhe shoqëror. Ky është një skenar për reforma të pjesërisht ose të kufizuara, që synojnë përmirësimin e klimës afariste ose shoqërore, pa qenë e domosdoshme që kjo të çojë drejt hyrjes në BE. Mundësitë dhe sfidat e kësaj gjendje mund të emërohen si në tabelën më poshtë.

	Mundësitë	Sfidat
<p>Qasja nr. 2:</p> <p>Statusi i vendit shoqërues</p>	<p>1. Tregtia e kompanive të Maqedonisë me BE po zbatohet më lehtë, edhe pse barrierat tregtare dhe jotregtare nuk janë mënjanuar plotësisht. Të gjitha përparësitë në lidhje me tregtinë më të lirë me BE duhet t'i rrisin vendet e punës dhe të sigurojnë të ardhura më të mëdha, PBB më të madh dhe reduktim të varfërisë, edhe pse në masë jashtëzakonisht më të vogël sesa në rastin e tregtisë së lirë.</p> <p>2. Lehtësimi i barrierave administrative, burokracisë dhe shkurtimeve të kohës së dërgimit do të duhej, poashtu, të kontribuojnë për këtë. Deri në një nivel të caktuar, duhet të arrihet shumëllojshmëria dhe cilësia e ofertës, si dhe çmimet e reduktuara të konsumatorëve maqedonas, edhe pse në masë shumë më të ulët sesa në rast të integritit të plotë.</p> <p>3. Ekspozimi në konkurrueshmëri më të madhe, produktiviteti dhe konkurrueshmëria e përmirësuar. Veç kësaj, në fillim çiltërsia mund të jetë asimetrike, me hapësirë më të madhe për produktet e Maqedonisë në tregun e BE, përderisa akoma po ekziston një mbrojtje e caktuar e këtyre produkteve.</p> <p>4. Hyrjet më të mëdha të investimeve nga BE dhe nga jashtë BE-së. Vendi po bëhet posaçërisht joshës për investim (sidomos nga jashtë BE-së) në pritje të periudhës së pranimit të plotë.</p> <p>5. Disa përparësi tjera të katër liritë të lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, punës dhe kapitalit duhet të fillojnë të bëhen të dukshme, si për shembull:</p>	<p>1. Katër liritë e Tregut të Vetëm të BE (lëvizja e lirë e mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe krahut të punës) nuk janë plotësisht funksionale dhe nuk mund ta realizojnë potencialin e përgjithshëm.</p> <p>2. Akoma ekzistojnë barrierat administrative dhe burokracia në lëvizjen e mallrave, kapitalit dhe punës.</p> <p>3. Politikat e BE janë ngajnjëherë joefikase dhe mund ta pengojnë fleksibilitetin, sidomos në rrafshin afarist.</p> <p>4. Lëvizja e punës është akoma e vështirë, sepse punonjësit e Maqedonisë akoma duhet të përmbushin shumë kërkesa për të fituar qasjen në Tregun Evropian, dhe në të njëjtën kohë ata akoma nuk gëzojnë të drejtat e njëjta si dhe punonjësit evropian.</p> <p>5. Veç kësaj, nuk ka udhëtime dhe qasje falas në shërbime shëndetësore në kuadër të BE-së, edhe pse mund të ekzistojnë rregulla të caktuara për lehtësimin e tyre.</p> <p>6. Në parim, ekziston qasja e kufizuar në fondet e BE-së. Njohja e ndërsjellë e standardeve dhe rregullave të mjedisit jetësor, sigurisë, shëndetit dhe sigurimit është poashtu e kufizuar.</p> <p>7. E fundit me renditje, por jo dhe sipas rëndësisë, përfitimet nga Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së, së bashku me subvencionet, nuk janë plotësisht të disponueshme.</p>


	Mundësitë	Sfidat
Qasja nr. 2: Statusi i vendit shoqëruar	<ul style="list-style-type: none"> •Duhet patur më tepër mundësi për biznese të ndryshme, për tregti dhe turizëm. •Disa mundësi për studime jashtë vendit për njerëz të rinj. •Përfitimet nga respekti i përmirësuar dhe njohja e standardeve dhe rregullave mbi mjedisin jetësor, sigurinë, shëndetin dhe sigurimin, por edhe, standardet sociale. 	

3. Qasjet e ndryshme: status quo

Skenari i fundit është status quo, apo gjendje brenda së cilës asgjë nuk ndryshon. Në rastin më të keq, kjo do të kishte nënkuptuar humbjen e statusit të kandidatit në BE, ose, barabartësisht, vendimin për të lënë anësh procesin e përgjithshëm të integritit në BE. Kjo do të thotë se ekonomia dhe rrethi afarist do të mbeten në pasiguri; kjo do të kishte qenë gjendje e pasigurisë dhe stagnacionit të shtuar. Mungesa e transparencës, çiltërsisë dhe rasteve të favorizimit, korrupsionit dhe mungesa e konkurrencës së ndershme do të mbeten çështje aktuale. Formalisht do të ekzistojë korniza juiridike dhe institucionale, por zbatimi i tyre dhe mbikëqyrja publike do të mbeten të varfëra. Nga ana tjetër, vendi do ta ruajë sovranitetin e vet ekonomik dhe mund të kërkojë opsione ekonomike dhe tregje në vende të tjera.

Është e vështirë të vlerësohen përparësitë e statusit quo.

	Mundësitë	Sfidat
Qasja nr. 3: Status quo	<ol style="list-style-type: none"> 1.Pa shpenzime të përshtatjes për integrim në BE. 2.Liberalizimi i vazhduar, por megjithatë i kushtëzuar i vizave. 3.Politika e pavarur kombëtare ekonomike. Prodhuesit e Maqedonisë nuk do të konkurrojnë brenda Tregut të Vetëm Evropian, ndërsa standardet e BE nuk do të përfshihen në rregulloret kombëtare për prodhimin dhe tregun. 4. Ruajtja e sovranitetit ekonomik 	<ol style="list-style-type: none"> 1.Zbatimi i pamjaftueshëm i katër lirive, pengesat e konsiderueshme gjatë lëvizjes së mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe punës. 2.Një pjesë e madhe e fondeve të BE nuk do të jenë në dispozicionin e qytetarëve, kompanive dhe organizatave të Maqedonisë. Hyrja e investimeve nga BE dhe nga jashtë BE-së do të mbeten në nivel të ulët. 3.Qasja e pamjaftueshme në arsim, shërbime shëndetësore dhe sociale në kuadër të BE-së. 4.Nuk do të materializohen mundësitë e tregtisë, turizmit, të ardhurat më të larta, PBB më i lartë dhe reduktimi i varfërisë. 5.Mosekzistimi i politikës së konkurrueshmërisë së BE, mosekzistimi i subvencioneve nga politika bujqësore e BE, dhe i politikave të ngjashme.



Shkup 18-19 nëntor 2017

Vendi: Hotel Kontinental, Shkup

DITA E PARË: 18 NËNTOR 2017

Arritja e pjesëmarrësve në hotelin Kontinental më së voni deri në orën 11.

KOHA	Sesioni
11.00 - 12.30	Vendosja në dhoma dhe regjistrimi i patjetërsueshëm
13:00 - 13.15	Hapja oficiale e evenimentit: Simonida Kacarska, EPI dhe Aleksandar Krzhalovski, Civica Mobilitas
13:15 - 13:30	Kalimi në grupet punuese, Ndiqni vullonterin/moderatorin e grupës tuaj
13:30 - 15:00	Puna në grupe për reformat demokratike, Dhomat 701-710 në katin e 7, Salla solemne
15:00 - 15:30	Pauzë
15:30 - 17:00	Sesioni plenar 1: Demokracia Folësit: Z. Talat Xhaferri, Znj. Besa Arifi, Z.Nikolla Dimitrov, Z.Bujar Osmani, Z. Nikolla Poposki
17:00 - 17:30	Përmbledhja e ditës
17:30 - 19:00	Darkë e përbashkët

DITA E DYTË: 19 NËNTOR 2017

KOHA	Sesioni
09:00 - 10:30	Puna në grupe për reformat ekonomike, Dhomat 701-710 në katin e 7, Salla solemne
10:30 - 11:00	Pauzë
11:00 - 12:30	Sesioni plenar 2: Ekonomia Folësit: Z.Fatmir Besimi, Znj.Silvana Mojsavska, Znj.Bllagica Petreski, Z. Marjan Nikollov, Z. Vanço Uzunov, Znj.Verica Haxhi Vasileva Markovska
12:30 - 13:30	Përmbyllja e evenimentit (pjesëmarrësit mbushin anketën përfundimtare)

Ç'ËSHTË ANKETA DEBATIVE¹²

Anketa debative është një formë unike e konsultimeve politike që kombinon teknikat e hulumtimit të opinionit publik dhe një debat publik për të përshkruar se si opinionit publik mund të jetë në një temë të veçantë, nëse qytetarët do të kenë një mundësi për ta njohur më tej temën. Si një metodë e anketimit, sondazhi debiti merr parasysh preferencat dhe opinionet e qytetarëve, para dhe pas mundësisë për të marrë vendime bazuar në informata dhe opinione nga bashkëqytetarët e tyre.

PËRSE?

Qytetarët shpesh nuk janë të informuar për çështjet kyçe të politikave publike. Sondazhet konvencionale paraqesin përshtypjet sipërfaqësore të publikut për deklaratat televizive dhe titujt. Publiku, i cili është subjekt i asaj që shkenca sociale e quajtur “inorancë racionale”, ka pak arsye për të shkëmbyer mendime ose për të investuar përpjekje në marrjen e informacioneve ose qëndrimeve të menduara. Anketa debative është një përpjekje për të shfrytëzuar sondazhet e opinionit publik në mënyrë të re dhe konstruktive. Kjo është veçanërisht e përshtatshme për çështjet për të cilat publiku ka pak njohuri ose informacione, ose për çështje për të cilën publiku ka dështuar t'i kapë avantazhet dhe disavantazhet e politikave të ndryshme publike. Anketa debative është eksperiment në shkencat shoqërore dhe një lloj i arsimit publik në kuptimin më të gjerë. Procesi është një përfaqësim statistikor i një ekzemplari shkencor, si dhe specificitetin dhe menjëhershmerinë e grupit të fokusit ose grupit të diskutimit.

SI?

Shikuar në përgjithësi, procesi i zbatimit të anketës debative, duke përfshirë dhe aktivitetet e ditës së debatit, mund të ndahet në proces pesë-hapësh:

1. Nga një ekzemplar të rastit dhe përfaqësues i qytetarëve është kërkuar që t'u përgjigjet pyetësorit i cili ka për qëllim vlerësimin e njohurive dhe perceptimeve të publikut për një çështje të caktuar.
2. Një ekzemplar tjetër i rastit dhe përfaqësues i qytetarëve është kontaktuar dhe është ftuar të merr pjesë në “ngjarjen debative” në kohëzgjatje nga një apo dy ditë.
3. Në ditët përpara ngjarjes, pjesëmarrësit e përzgjedhur marrin materiale të balancuara informative në lidhje me temën e cila do të diskutohet, të miratuara nga ekspertë.
4. Në ditën e “ngjarjes debative” pjesëmarrësit me zgjedhje të rastit po ndahen në grupe të vogla me moderatorë të trajnuar. Gjatë sesioneve grupore, pjesëmarrësit inkurajohen të zhvillojnë pyetje të cilat do të parashtrihen gjatë panelit të ekspertëve gjatë një seance plenare e cila do të mbahet në fund të “ngjarjes debative”.
5. Në fund të ngjarjes, të gjithë pjesëmarrësit po mbushin një pyetësorin e dytë, i cili është menduar për të vlerësuar qëndrimet e tyre të menduara për temën e diskutimit. Rezultatet e anketës së parë dhe të dytë po krahasohen, dhe në rast të çfarëdo ndryshimesh të opinionit publik, maten dhe analizohen nga anketues të trajnuar. Në shumicën e rasteve, rezultatet e anketës së dytë i dërgohen publikut nëpërmjet të mediave, dhe në raste të caktuara, ato paraqesin dhe pikënisje për debat dhe diskutim të mëtejshëm midis politikanëve dhe politikëbërësve.

12 Anketa debative (deliberative polling) si metodë është regjistruar nga Qendra e Demokracisë Debative të Universitetit Stanford: <http://cdd.stanford.edu>